

INTEGRITETI



INTEGRITET DHE ETIKË

SEMPER VIGILE

> IPK.RKS-GOV.NET

Alo IPK



 080003333

POLICOR I KOSOVËS
INSPEKTORAT KOSOVA
NATIONAL POLICE SERVICE OF KOSOVO

2 911, ipk.rks-gov.

“Linja e kaltër” në shërbim të qytetarëve

Revistë e Inspektoratit Policor të Kosovës >> Nr. 4, Viti II / 2014

INTEGRITETI

INTEGRITET DHE ETIKË

Alo

INTEGRITETI

INTEGRITET DHE ETIKË

SEMPER VIGILE

Alo IPK

> IPK.RKS-GOV.NET

☎ 080003333

“Linja

“Linja e kaltër” në shërbim të qytetarëve

info

zimp.ipk@rks-gov.net

Revista “Integriteti” është botim i Inspektoratit Policor të Kosovës

Divizioni për Marrëdhënie me Publikun dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar

Botues: Inspektorati policor I Kosovës

Kryeredaktor:
Arbër BEKA

Bashkëpunëtorë:
Edona Haqifi dhe
Skender Hoti

Tel: +377 (0) 44 146 696
E-mail: arber.beka@rks-gov.net,
arberbeka@gmail.com, zimp.ipk@rks-gov.net

INTEGRITETI

4-5

Bashkëpunimi me qytetarët



PËRMBAJTJA

HETIME

BASHKËPUNIM DHE KOORDINIM, 10-11

INSPEKTIVE

TAKIMET PËRMBYLLËSE, 14-15

6-7

Vrajolli - Inspektimi mekanizëm parandalues



INSPEKTIVE

IPK INSPEKTON TRAJNIMET DHE NJOHURITË E ZYRTARËVE POLICOR LIDHUR ME PËRDORIMIN E FORCES, 16, 17

12-13

Alo IPK "Linja e kaltër" në shërbim të qytetarëve



THIRRJET EMERGJENTE

INSPEKTOHET MENAXHIMI I THIRRJEVE EMERGJENTE NË POLICINË E KOSOVËS, 18-19

TRAJNIME

SHKOLLA E STAFIT POLICOR DHE KOMANDËS, 21

9

Konferenca e 5-të e agjencive të kontrollit të brendshëm



PIKË SHITESË:

Mendimet, komentet, këndvështrimet e shprehura ose të përfshira në përmbajtje të këtij botimi nuk paraqesin medeomos politikat ose vështrimet zyrtare të IPK-së.



Fitim Shishani
Kryeshef i IPK-së

FOTO: INTEGRITETI

Bashkëpunimi me qytetarët faktor kyç në realizimin e detyrave tona

Inspektorati Policor i Kosovës, është institucion mbikëqyrës ndaj Policisë së Kosovës, i cili punon për t'i shërbyer qytetarëve duke ju ofruar atyre një siguri dhe garanci për realizimin e të drejtave të tyre Kushtetuese. Duke ditur rëndësinë që ka bashkëpunimi ynë me qytetarët, i cili bashkëpunim mund të quhet edhe faktor kyç në realizimin e detyrave tona, në kemi përpiluar strategji të veçanta në lidhje me informimin, kërkimin e ndihmës, këshillimin dhe mbështetjen e qytetarëve. Punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës, mbajnë gjithmonë parasysh, se nuk mjafton përsosja e organizimit të shërbimeve tona, ne e dimë se, rritja e profesionalizmit dhe shpejtësisë për hetimin e dukurive negative brenda policisë, veprimet e shpejta për të parandaluar, zbuluar shkelësit e ligjit para drejtësisë etj, nuk do të kishin fuqinë e duhur pa përmirësimin e shërbimeve për qytetarë. Jam i lumtur që në drejtim të fuqizimit të bashkëpunimit të IPK-së me qytetarët po

Duke ditur rëndësinë që ka bashkëpunimi ynë me qytetarët, i cili bashkëpunim mund të quhet edhe faktor kyç në realizimin e detyrave tona, në kemi përpiluar strategji të veçanta në lidhje me informimin, kërkimin e ndihmës, këshillimin dhe mbështetjen e qytetarëve.

Ne kemi për qëllim që të krijojmë kushtet dhe të shërbejmë me etikë profesionale me sjellje dhe komunikim të kulturuar, për të dëgjuar me shumë kujdes për të zgjidhur ankesat dhe për të dhënë sqarime të nevojshme qytetarëve tanë

realizojmë projektin e “ Linjës së Kaltër “, në shërbim të qytetarëve, duke ofruar numrin e veçantë të telefonit pa pagesë. Ne kemi për qëllim që të krijojmë kushtet dhe të shërbejmë me etikë profesionale me sjellje dhe komunikim të kulturuar, për të dëgjuar me shumë kujdes për të zgjidhur ankesat dhe për të dhënë sqarime të nevojshme qytetarëve tanë.

Ne jemi shumë të vetëdijshëm se këto shërbime ndaj qytetarëve, krijojnë imazhin pozitiv ose negativ, prej të cilit edhe mund të formohet qëndrimi i komunitetit, prandaj, IPK-ja ka ndërmarrë të gjitha masat dhe me kohë ka përfunduar trajnimin adekuat të zyrtarëve të vet për trajtimin me efektivitet dhe efikasitet të informacioneve që pritet të arrijnë përmes këtij projekti. Jam i bindur se zyrtarët e IPK-së, do ti kushtojnë vëmendje të veçantë përsosjes së kulturës dhe etikës në trajtimin e qytetarëve me rastin e komunikimit në këtë linje pa pagesë.

Përmes projektit “ Linja e kaltër “ Inspektorati

Policor i Kosovës po realizon detyrimin ligjor i cili kërkon profesionalizmin e institucioneve që merren me ankesat e individit ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut në këtë rast nga ana e policisë. Ky është edhe qëllimi strategjik i IPK-së i paraparë në Planin Zhvillimor Strategjik të IPK-së 2012 – 2015. Ne mendojmë se ky projekt do ta ndihmoj edhe Policinë tonë në përmirësimin e shërbimeve që ofrojnë për publikun.

Fare në fund, dua të shpreh përcaktimin tim si udhëheqës i IPK-së, si një institucion shumë i rëndësishëm për sigurinë e vendit tonë, që së bashku me çdo punonjës të IPK-së, do të bashkëpunojmë me qytetarët tanë, do të krijojmë, frymëzojmë e sigurojmë mbështetje ndaj tyre, sepse jemi të bindur se kjo do të shpërblehet me besimin , përkrahjen dhe mbështetjen e qytetarëve për Shërbimet dhe punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës.

Faleminderit !



VRAJOLLI – Inspektimi është

Sa ka ndryshuar metoda e punës në Departamentin e Inspektimeve, sa po zbatohen rekomandimet nga fushat e inspektuara, kush dizajnoi logon e IPK-së, cila është domethënia e simboleve të përdorura në këtë logo?

Për të marrë përgjigjet në këto dhe pyetje të tjera, në profilin e zgjedhur për këtë numër të radhës të revistës “Integriteti” lexoni intervistën me udhëheqësin e Departamentit të Inspektimeve – Arben Vrajolli.

Arben Vrajolli. I lindur në Prishtinë në vitin 1977. Nga viti 2001 deri në vitin 2005 ka kryer fakultetin e Shkencave Politike dhe Administratës Publike në Universitetin e Prishtinës, vazhdon me master në fakultetin Juridik drejtimi; Kushtetues Administrativ. Ishte gjenerata e 31-të e Policisë së Kosovës ku vijoi trajnimin në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri në vitin 2005. Më pastaj punoi si zyrtar policor në stacionin policor Qendra në Prishtinë. Në vitin 2006 u punësua si inspektor në Inspektoratin Policor të Kosovës. Tani me shumë përkushtim ushtron funksionin Udhëheqës i Departamentit të Inspektimeve.

Integriteti: Jeni ndër punonjësit e parë të Inspektoratit Policor të Kosovës me një përvojë sidomos në fushën e inspektimeve, sa ka ndryshuar metodologjia e punës në inspektime?

Vrajolli: Inspektorati Policor i

Arben Vrajolli. I lindur në Prishtinë në vitin 1977. Nga viti 2001 deri në vitin 2005 ka kryer fakultetin e Shkencave Politike dhe Administratës Publike në Universitetin e Prishtinës, vazhdon me master në fakultetin Juridik drejtimi; Kushtetues Administrativ. Ishte gjenerata e 31-të e Policisë së Kosovës ku vijoi trajnimin në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri në vitin 2005. Më pastaj punoi si zyrtar policor në stacionin policor Qendra në Prishtinë. Në vitin 2006 u punësua si inspektor në Inspektoratin Policor të Kosovës. Tani me shumë përkushtim ushtron funksionin Udhëheqës i Departamentit të Inspektimeve.

Kosovës, që nga ndryshimet e fundit ligjore dhe organizative të vitit 2010-11 në të gjitha segmentet e saja ka pasur një evoluim shumë të shpejt në sensin e ngritjes së efikasitetit në zbatimin e mandateve të saja. Në metodologjinë e inspektimeve ka pasur shumë ndryshime evolutive të cilat kanë ngritur cilësinë e punës në zbatim të funksioneve inspektuese të cilat kanë ardhur si rezultat i përkushtimit të menaxhmentit dhe tërë stafit të IPK-së, si dhe nga kontributi i pa zëvendësueshëm nga ICITAP-i Amerikan të cilët në mënyrë konstante kanë punuar dhe kanë përkrahur menaxhmentin dhe stafin e IPK-së. Deri në vitin 2010, IPK ishte në fazën e parë të pjekurisë institucionale dhe kishte në përdorim ende protokoll apo programe inspektimi të cilat ishin të hartuara gjatë vitit 2006 nga OSBE, të cilat për kohën ishin shumë të mira, mirëpo me ndryshimet e mëdha legjislative pas Pavarësisë së Kosovës ato kishin filluar të ishin jo funksionale.

Departamenti i Inspektimeve është duke përdorur me sukses edhe metodën e takimit përmbyllës me udhëheqësit e njëjësive të inspektuara të cilëve u dorëzohet një draft raport inspektimi para se ai të bëhet finale dhe u ipet mundësia që të analizojnë të gjeturat e raportit të IPK-së.

Integriteti: Në takimin në mes IPK-së dhe PK-së është përmendur edhe identifikimi i fushave të përbashkëta



ë një mekanizëm parandalues



të inspektimit, si planifikoni ta realizoni këtë?

Vrajolli: Po, edhe përkundër këtyre të arriturave përmbajtjesore, sikurse IPK, ashtu edhe Departamenti i Inspektimeve nuk do të kënaqet me

këto zhvillime dhe nuk do të ndalet se vepruari për të ngritur përformancën e saj në drejtim të zhvillimit dhe të arritjes së standardeve më të larta të mundshme. Ajo që është me rëndësi për tu kuptuar si nga Policia e

Kosovës, po ashtu edhe nga gjithë të tjerët është se inspektimet që bëhen në Policinë e Kosovës nuk kanë karakter ndëshkues. Inspektimi është një mekanizëm, i shkëlqyer parandalues i cili paralajmëron autoritetet vendimmarrëse lidhur me vështirësitë, problemet, të metat e sistemit si dhe për të gjitha këto ofron zgjedhje. Në çdo fillim të vitit do të organizojmë një takim të përbashkët IPK-PK, për të bërë një analizë gjendjes së përgjithshme të Policisë së Kosovës, ku do të identifikoheshin anët e forta dhe të dobëta të Policisë së Kosovës. Pastaj do të identifikoheshin mundësitë dhe rreziqet, dhe si rezultat i kësaj analize do të kishim disa fusha për të cilat IPK, do të zhvillonte inspektime konkrete të pavarura si dhe inspektime të përbashkëta me Policinë e Kosovës, aty ku është e nevojshme.

Takimet e tilla do të kontribuonin shumë në pavarësinë dhe integritetin e institucioneve tona duke ngritur cilësinë e punës me qasje të strukturuar dhe afatgjate për dy institucionet që kanë emëruar të përbashkët, shërbim për qytetarët e Kosovës.

Integriteti: Sa po zbatohen rekomandimet e dalta nga inspektimet për Policinë e Kosovës?

Vrajolli: Bashkëpunimi IPK-PK, nga viti në vit është duke u rritur, kjo vjen duke parë çdo ditë e më shumë kërkesat dhe nevojat e qytetarëve

për shërbimet tona të cilat ne u ofrojmë qytetarëve, po ashtu edhe rekomandimet e IPK-së, nga viti në vit janë duke u implementuar gjithnjë e më shumë. Ky komunikim i cili është vënë në zbatim garanton se këto rekomandime do të implementohen. IPK ka vënë në funksion edhe inspektimet përcjellëse me të cilat në afate të caktuara kohore

bënë verifikimin e implementimit të rekomandimeve të dhëna më herët për të cilat raporton tek autoritetet vendimmarrëse.

Integriteti: Me themelimin e IPK-së, ky institucion nuk kishte logo të veten. Propozimi juaj për logon e IPK-së, ishte ai që u përzgjedh si fitues.

Vrajolli: Ne në atë kohë ishim një klasë prej 20 inspektorëve që gjatë trajnimit na caktonin detyra të ndryshme ekipore të cilat kishin për qëllim ndërveprimin tonë në formë ekipore pasi që natyra e punës inspektuese është e tillë. Një detyrë e tillë ishte edhe ndarja e klasës në ekipe dhe detyra ishte dizajnimi i logos së Inspektoratit Policor të Kosovës. Instruksionet ishin: të jeni sa më kreativë, sa më origjinal dhe mundësisht ti shmangeni figurave të gjalla. Fillimisht u ndamë në grupe nga tre, unë isha në një nga këto grupe mirëpo pasi insistova që të marr një figurë nga bota e gjallë për logo (shqiponjën), u ndava nga grupi dhe punova vetëm.

Ideja për logo parimisht ishte e thjeshtë, të jetë diçka që përfaqëson atributet tona që kemi si institucion. Duke qenë se jemi

organ mbikëqyrës i një institucioni shumë të rëndësishëm siç është Policia e Kosovës dhe se kemi dy mandate: Hetimin dhe Inspektimin, duhet të jetë simbol i mbikëqyrjes, pastërtisë dhe integritetit. Si e tillë kush mund të ketë këto attribute më shumë se shqiponja. Ky shpend njihet si largpamës dhe me


Hetimet dhe Inspektimet të cilat bashkojnë krahët dhe formojnë një formë të çatisë së përbashkët që ndodhet edhe mbishkrimi lartë në formë pergamenë ku shkruhet Inspektorati Policor i Kosovës. Në mes të shqiponjës gjendet një llupë në formë rrethore, në të cilën gjenden inicialet IPK dhe

t r e y j e q e simbolizojnë tre pushtetet: Legjislativin, Ekzekutivin dhe Gjyqësorin, si dhe vitin e themelimit 2006. Këmbët

e shqiponjave qëndrojnë mbi një pergamenë tjetër në të cilin gjendet mbishkrimi latinisht "SEMPER VIGILE" që d.m.th GJITHMONË VIGJILENT. E tërë kjo është e vendosur në një mburojë mesjetare që simbolizon qëndresën dhe sigurinë. Ngjyrat janë ngjyrat e metaleve fisnike, pra janë vetëm dy ngjyra: ngjyrë ari shqiponjat dhe argjendi mburojën dhe për brendinë e llupës.

Integriteti: A iu ka ndihmuar dikush deri në finalizimin e logos, apo të tëra i keni bërë vet ?

Vrajolli: Po, pasi kam vizatuar me dorë, versionin e parë e që është rreth 90 %, ky i cili kemi sot, i janë shtuar edhe disa elemente tjera p.sh nuk ishte mbishkrimi "SEMPER VIGILE", kjo kishte ardhur më vonë nga trajnerët tanë nga OSBE. Pastaj kemi pasur disa versione të mburojës, version i parë i mburojës ishte i përafërt me këtë version që ka sot, vetëm se nuk kishte ato lakimet që ka sot sipër. Pastaj versioni elektronik është bërë nga një kontraktues i cili ka realizuar me përpikëri versionin që kam vizatuar me dorë.



mprehtësi të shikimit, është simbol fisnikërie për shumë popuj, shtete dhe familje mbretërore.

Integriteti: Na shpjegoni pak për lexuesin dizajnin, ngjyrat, elementet e logos?

Vrajolli: Dizajni i dy shqiponjave të kthyer me shpinë nga njëra tjetra, simbolizojnë dy funksionet e IPK-së,



Konferenca ishte e fokusuar në koordinimin dhe bashkëpunimin në mes të njësive të kontrollit të brendshëm dhe prokurorit publik, për sistemin e ankesave për qytetarë dhe zyrtarë policorë si dhe në menaxhimin e burimeve njerëzore në përkrahje të mekanizmave efektiv të kontrollit të brendshëm

U MBAJT KONFERENCA E 5-të E AGJENCIVE TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Maqedonia ishte vendi nikoqir i konferencës së 5-të me radhe të agjencive të kontrollit të brendshëm e titulluar “Sfidat aktuale të njësive të kontrollit të brendshëm në mbështetje të shërbimit modern policor”.

Kjo konferencë u organizua nga misioni i OSBE-së, DCAF-i dhe nga Ministria e Punëve të Brendshme të Maqedonisë duke ftuar zyrtarët e kontrollit të brendshëm nga vendet e rajonit dhe më gjerë.

Delegacioni nga Kosova u përfaqësua nga Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së z. Fitim Shishani deri sa si pjesë e delegacionit ishte edhe udhëheqësi i Departamentit të Inspektiveve z. Arben Vrajolli dhe kolonel Izet Azizi nga Drejtorja e Standardeve Profesionale.

Këtë vit konferenca ishte e fokusuar në koordinimin dhe bashkëpunimin në mes të njësive të kontrollit të brendshëm dhe prokurorit publik, për sistemin e ankesave për qytetarë dhe zyrtarë policorë si dhe në menaxhimin e burimeve njerëzore në përkrahje të mekanizmave efektiv të kontrollit të brendshëm.

Delegacioni nga Republika e Kosovës prezantoi para përfaqësuesve të shteteve tjera pjesëmarrës në këtë



konferencë se si funksionon në Kosovë sistemi i ankesave për qytetarë dhe zyrtarë policorë.

Si praktika të mira nga delegacioni i Kosovës u potencua mundësia e dhënë qytetarëve të vendit që të ankojnë kundër shkeljeve policore në një agjenci të pavarur nga policia (IPK) duke ofruar garanci për qytetarët që ankesat e tyre do të trajtohen në interes të publikut si dhe caktimi i prokurorëve të veçantë që merren me raste të IPK-se në çdo regjion.

Përveç këtyre si praktikë e mirë u potencua edhe delegimi i autorizimit për trajtimin e shkeljeve të lehta di-

sipline tek menaxheret e vijës së parë dhe vijës së dytë komanduese të Policisë së Kosovës.

Kjo shihet si një mundësi për menaxherët policorë që të kenë në duart e tyre një mjet përmes të cilit do të mund të ngrisin drejtpërdrejt nivelin e disiplinës dhe të kenë përgjegjësi të plotë lidhur me menaxhimin e njësive të tyre.

Përndryshe, konferenca të tilla janë mundësi e mirë për shkëmbimin e praktikave më të mira të mekanizmave të kontrollit të brendshëm duke kontribuar së bashku për rezultate më të frytshme në këtë fushë.

Inspektorati Policor i Kosovës dhe Prokuroria e Shtetit kanë krijuar raporte të mira të bashkëpunimit në luftimin e dukurive negative të cilat hasen në radhët e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës



Bashkëpunimi

Me plotësim ndryshimet në ligjin e IPK-së që hyri në fuqi në dhjetor të vitit 2010 (03/L-231), Inspektoratit Policor ju fuqizua rolin e i saj duke ndryshuar tërësisht objektin e veprimtarisë hetuese duke hetuar veprat penale ku janë të përfshirë si të dyshimtë zyrtarët policorë.

Reformat e ndërmarra me vite (ligji i ri, udhëzimet e reja administrative) që kanë pasur për qëllim fuqizimin e Inspektoratit Policor të Kosovës kanë dhënë rezultate të konsiderueshme në praktikë.

Pas miratimit të këtij ligji, kjo konsiderohej një sfidë që ndërli dhej me transformimin e IPK-së në aspektin funksional dhe organizativ, bartjen e përgjegjësisë nga niveli i ndjekjes disiplinore në nivel të ndjekjeve penale si dhe ristrukturimin organizativ

nga një strukturë organizative me dy departamente në një strukturë organizative me pesë departamente.

Bazuar në kompetencat e dala nga ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës, IPK-ja është e obliguar që të pranoj të gjitha ankesat e qytetarëve si dhe të shqyrtoj dhe përcaktoj se cila nga ankesat hetohet nga IPK-ja dhe cilat do ti referohen Policisë së Kosovës apo institucioneve tjera përgjegjëse. Sipas këtij ligji Inspektorati Policorë i Kosovës është i obliguar që të hetoj të gjitha rastet ku janë të involvuar punonjësit e Policisë së Kosovës e të cilat kanë elemente të veprës penale apo shkelje disiplinore të profilit të lartë ku përfshihen zyrtarët policorë të nivelit të lartë menaxherial dhe ekzekutiv.

Hetuesit e IPK-së me autorizimet e





JETULLAH ALIU, UDHËHEQËS I DEPARTAMENTIT TË HETIMEVE
NË IPK NË TAKIM ME Z. JETISH MALOKU, KRYEPROKURORI I
PROKURORISË NË GJILAN

m dhe koordinim



KRYEPROKURORI I
PROKURORISË NË GJILAN
Z. JETISH MALOKU

reja ligjore hetuesit e IPK-së morën autorizime policore të cilat i ushtrojnë ato në përputhje me Kushtetutën, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale si dhe me ligjet dhe aktet nënligjore tjera në fuqi.

Kompetencat e reja të hetimit të veprave penale ku janë të përfshirë zyrtarët Policor sollën nevojën e fuqizimit të bashkëpunimit me Prokurorinë e Shtetit.

Jetullah Aliu, udhëheqës i Departamentit të Hetimeve në IPK përshkruan sfidat të cilat tani mund të konsiderohen si të tejkaluara:

“Me ndryshimet ligjore dhe fuqizimin e kompetencave të IPK-së në fillim u ballafaquam me disa vështirësi pasi që deri atëherë Inspektorati trajtonte vetëm rastet e shkeljeve disiplinore. Me vizionin e Kryeshefit

Ekzekutiv z. Fitim Shishani, pastaj përkrahjen e MPB-së dhe posaçërisht ICITAP-it amerikan përmes trajnimeve konkrete nga fushat e nevojshme për ngritjen e cilësisë së punës në IPK u tejkaluan këto sfida fillestare” – theksoi z. Aliu duke cekur edhe nivelin e lartë të bashkëpunimit me Prokurorinë.

“Autorizimet e reja hetimore sollën nevojën edhe për bashkëpunim me prokurorët dhe duhet të theksoj përkrahjen e tyre që nga fillimi. Me kërkesën e menaxhmentit të IPK-së drejtuar Kryeprokurorit të Shtetit është caktuar një Prokuror i veçantë për të punuar me IPK-në dhe kjo është arritur deri tani në shumë prokurori si në Prishtinë, Gjilan, Ferizaj, Prizren dhe Gjakovë” – potencoi për revistën “Integriteti” z. Aliu.

Inspektorati Policor i Kosovës dhe Prokuroria e Shtetit të Republikës së Kosovës kanë krijuar raporte të partneritetit dhe bashkëpunimit në luftën e dukurive negative të cilat hasen në radhët e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës.

Po ashtu bashkëpunim të mirë IPK-ja ka edhe me shërbimet administrative të Prokurorive, ku ky shërbim konsiston në dhënien e informacioneve të sakta dhe të shpejta lidhur me rastet të cilat IPK-ja i ka proceduar në Prokuroritë kompetente.

Këtë nivel të bashkëpunimit e vë në pah edhe Kryeprokurori i Prokurorisë në Gjilan z. Jetish Maloku:

“Me kënaqësi, theksoj se Institucioni i Prokurorisë ka një bashkëpunim shumë të mirë me të gjitha agjencitë për zbatimin e ligjit e sidomos me Inspektoratin Policor të Kosovës, me zyrtarët e të cilëve është gjithnjë në koordinim për të gjitha rastet eventuale të hetimit dhe për çfarëdo rasti që kërkon bashkëpunim dhe koordinim të këtyre dy institucioneve. Ky bashkëpunim është ngritur në nivelin më të lartë posaçërisht nga viti 2013 kur prokuroritë themelore në Kosovë caktuan nga një prokuror-zyrtar kontaktues me IPK-në” – theksoi z. Maloku duke potencuar se ky nivel i bashkëpunimit vetëm sa do të fuqizohet.

ALO IPK

“Linja e kaltër” në shërbim të qytetarëve

Inspektorati Policor i Kosovës lëshoi
në përdorim edhe një numër pa pagesë për
qytetarët e vendit nga seria 0800



080003333



2 911



2 911



080003333

ipk.rks-gov.net

info.ipk@rks-gov.net

Komuni-kimi përmes telefonit njihet si një është mënyra më e shpejt e komunikimit të ndërsjellë mes qytetarëve dhe qendrës së thirrjeve në IPK. Po ashtu rëndësi të veçante ka dërgimi i mesazheve të dërguara në telefon dhe pranimit i informatave nga qytetarët përmes telefonit, shpesh herë komunikimi me telefon me qytetarët shërben si hap i parë për të plasuar një informatë me rëndësi apo informatë të natyrës urgjente e cila pa vonësë plotësohet me informata shtesë, qofshin ato telefonike apo të shkruara.

Qytetarët mund të kontaktojnë tani me IPK-në edhe përmes numrit 080003333 i cili do të jetë në shërbim të tyre 24 orë në ditë dhe shtatë ditë në javë.

Kjo u realizua në kuadër të një projekti të IPK-së që synon fuqizimin e bashkëpunimit me qytetarë duke dhënë një mundësi shtesë për komunikim me qytetarët përmes

numrit të telefonit pa pagesë.

Ky projekt është në përputhje me vizionin e IPK-së që qytetarët e Kosovës të mund të kenë qasje në shërbim kompetent dhe etik nga IPK-ja dhe Policia e Kosovës.

Projekti është në përputhje edhe me Planin Zhvillimor strategjik të IPK-së 2012 -2015 qëllimi strategjik nr. 3: “Përpjekje efektive e IPK-së gjatë komunikimit në terren për t’iu siguruar qytetarëve dhe palëve të interesuara, informacione relevante, në kohë dhe të rifreskuara”.

Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) iu përgjigj pozitivisht kërkesës së IPK-së për sigurimin e një numri nga seria 0800.

Pas sigurimit të numrit pa pagesë dhe vendimit nga ARKEP-i, Inspektorati Policor mori mbështetjen e nevojshme

nga operatorët mobil të licencuar për funksionalizimin e numrit.

Me përkrahjen e operatorëve të licencuar të telefonisë mobile si PTK Vala, IPKO dhe Z-mobile ky numër tani është vënë në përdorim.

IPK ka përgatitur edhe Procedurën standard të veprimit e cila ofron udhëzime të përgjithshme për detyrat dhe aktivitetet kryesore që duhet të kryhen nga zyrtarët e IPK-së lidhur me menaxhimin- trajtimin e thirrjeve telefonike nga qytetarët.

Edhe Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, z.Fitim Shishani shprehu fjalë miradije për këtë projekt:

“Ky projekt pritet të ndikojë pozitivisht në ngritjen e nivelit të bashkëpunimit në mes IPK-së dhe qytetarëve të vendit por edhe ngritjes së përgjegjshmërisë së policisë si një institucion vital për sigurinë në Republikën e Kosovës” – theksoi z. Shishani në një

prononcim për revistën Integriteti.



PAMJE NGA TAKIMET PËRMBYLLËSE

TAKIMET PËRMBYLLËSE GARANCI PËR RAPORTE KUALITATIVE

Këto takime realizohen me qëllim të diskutimit dhe argumentimit të të gjeturave dhe rekomandimeve për adresimin e çdo rrethane që në mënyrë negative ndikon në efektivitetin e policisë dhe performancën e saj. Edhe në vitin 2014, IPK ka vazhduar me inspektimin e strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës për të siguruar llogaridhënie, efektivitet dhe efikasitet në zbatimin e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit në fuqi. Raportet e inspektimit theksojnë qartë kriteret objektive të gjendjes dhe përmbajnë rekomandime për

adresimin e çdo rrethane që në mënyrë negative ndikon në efektivitetin e policisë dhe performancën e saj. Ajo se çka ka qenë më ndryshe se viteve paraprake janë takimet përmbyllëse të organizuara pas secilës fushë së inspektuar. Këto takime flasin më së miri për përpjekjet drejt fuqizimit të bashkëpunimit të mirëfilltë në mes Inspektoratit Policor të Kosovës dhe Policisë së Kosovës (PK-së), që pas përpilimit të draft raporteve nga çfarëdo fushe inspektuese të caktojë takime përmbyllëse në mes të dy këtyre organizatave.

Këto takime përmbyllëse realizohen me qëllim të diskutimit dhe argumentimit të të gjeturave që IPK do ti prezantojë në raportet e inspektimeve të zhvilluara. Për më tutje, Departamenti i Inspektimeve (DI) gjatë këtij viti ka realizuar katër takime përmbyllëse të cilat janë zhvilluar në mes përfaqësuesve të DI-së dhe zyrtarëve të PK-së. Takimet janë ndarë në dy periudha ku fillimisht tema diskutimi kanë qenë dy fushat inspektuese “Vlerësimi i Menaxhimit të Trafikut Rrugor në Policinë e Kosovës” dhe “Vlerësimi i

Trajnimit dhe Njohurive të Zyrtarëve Policor lidhur me Përdorimin e Forcës”, si dhe dy fushat tjera “Vlerësimi i Kujdesit të Zyrtarëve Policor për Përdorimin e Automjeteve Zyrtare të Policisë së Kosovës” si dhe “Inspektimi i Menaxhimit të Thirrjeve në Policinë e Kosovës”, të cilat janë realizuar në ambientet e Policisë së Kosovës.

Gjatë takimit të parë ku fillimisht temë diskutimi kanë qenë dy fushat e para inspektuese të pranishëm nga ana e IPK-së kanë qenë udhëheqësit e dy divizioneve pranë DI-ve si dhe inspektorët të cilët kanë qenë të angazhuar përtëzhvilluar inspektimet, kurse PK-së është përfaqësuar nga ana e Drejtorit të Departamentit për

Operacione, komandantët e Njësive Rajonale të Komunikacionit Rrugor, si dhe të gjithë drejtorëve rajonalë policor.

Po ashtu gjatë takimit të dytë nga ana e IPK-së, është përcjellur përbërja e njëjtë e përfaqësimit, vetëm se është bërë ndryshimi i inspektorëve të cilët kanë qenë të angazhuar në dy fushat tjera inspektuese. Ndërsa PK-së është përfaqësuar nga ana e drejtorit të Divizionit për Bashkësi dhe Preventivë, shefat e operativës të të gjitha drejtorive rajonale policore, drejtoritë për Siguri dhe Mbikëqyrje të Komunikacionit Rrugor, dhe përfaqësuesve nga ana e drejtorive rajonale.

Gjatë diskutimeve në këto takime,

theksi u vu në frymën e argumentimit të të gjeturave të cilat janë prezantuar në raportet e inspektimit, me qëllim që të ju jepet përgjigje pozitive të dhënave apo ndonjë lëshimi teknik të të gjeturave.

Kontributi i pjesëmarrësve në takim ka qenë i jashtëzakonshëm, ku të gjithë janë pajtuar me të gjeturat që janë prezantuar në raportet e inspektimit, duke konsideruar se të gjitha të gjeturat janë të bazuara dhe prezantojnë realitet të punëve policore për periudhën e caktuar.

Nga Edona Haqifi
Udhëheqëse e Divizionit të
Inspektimeve të Operativës në PK-së



IPK inspekton trajnimet dhe njohuritë e zyrtarëve

Bazuar në numrin e rasteve të raportuara në IPK ku zyrtarët e PK-së ishin të dyshuar për “lëndim të lehtë trupor”, Departamenti i Inspektimeve ka ndërmarr një inspektim lidhur me “Vlerësimin e trajnimeve dhe njohuritë e zyrtarëve policor lidhur me përdorimin e forcës”

Në secilin shtet demokratik policia i nënshtrohet një presioni për të luftuar krimin në rritje dhe kërcënimet që i kanosen sigurisë. Megjithatë, kjo nënkupton edhe atë se policia duhet të operojë gjithmonë në përputhje me ligjet vendore dhe standardet për të drejtave të njeriut.

Edhe pse përdorimi i forcës është shpesh i domosdoshëm që policia të kryejë detyrën në mënyrën e duhur (në parandalimin e një krimi apo për një arrestim të ligjshëm të shkelësve apo të dyshuarve për shkelje), zyrtarët policorë duhet të veprojnë në bazë të parimit se përdorimi i forcës duhet të konsiderohet si masë e jashtëzakonshme dhe duhet të jetë në raport me rrezikun duke minimizuar dëmet dhe lëndimet dhe duhet të përdoret vetëm deri në pikën e arritjes së objektivit të ligjshëm.

Bazuar në këtë, si dhe në numrin e rasteve të raportuara në IPK ku zyrtarët e PK-së ishin të dyshuar për “lëndim të lehtë trupor”, Departamenti i Inspektimeve ka ndërmarr një inspektim lidhur me “Vlerësimin e trajnimeve dhe njohuritë e zyrtarëve policor lidhur me përdorimin e forcës”.

Përmes këtij inspektimi janë vlerësuar programet trajnuese të zyrtarëve policor lidhur me përdorimin e forcës, vlerësimin e bazës ligjore për programet trajnuese të përdorimit të forcës, vlerësimin e gjendjes së vijueshmërisë të zyrtarëve policor në këto trajnime dhe vlerësimin e efekteve të njohurive të marra në këto trajnime.

Të gjeturat nga ky inspektim tregojnë se infrastruktura ligjore konkretisht udhëzimi administrativ Nr. 02/2012 që rregullon fushën e përdorimit të forcës është i përcjellur me mospërputhshmëri në mes përkufizimit të përdorimit të forcës, raportimit të saj dhe formularit për përdorimin e forcës. Për sqarime të mëtejme, Udhëzimi Administrativ 2/2012 për përdorimin e forcës nga ana e zyrtarëve policorë në kuadër të përkufizimeve nuk e definojnë se çka nënkupton “forcë fizike”

Procedurë policore lidhur me përdorimin e forcës

Bazuar në numrin e rasteve të raportuara në IPK ku zyrtarët e PK-së ishin të dyshuar për “lëndim të lehtë trupor”, Departamenti i Inspektiveve ka ndërmarr një inspektim lidhur me “Vlerësimin e trajnimeve dhe njohuritë e zyrtarëve policor lidhur me përdorimin e forcës”



e cila është kategori e përkufizimit të përdorimit të forcës. Po ashtu, formulari për përdorimin e forcës nuk parasheh raportim të përdorimit të forcës tek përdorimi i mjeteve pranguese, si rezultat i së cilës ka një diferencë në mes plotësimit të formularëve për përdorimin e forcës dhe personave të arrestuar .

Nga inspektimi i kryer në fushën e Trajnimeve për përdorimin e forcës dhe njohurive të zyrtarëve policor mbi përdorimin e forcës nga policia, IPK-ja ka nxjerrë në pah gjendjen aktuale të funksionimit të Policisë së Kosovës, duke identifikuar punën dhe praktikën e mira që aplikon kjo organizatë. Po ashtu janë evidentuar vështirësitë dhe ngecjet me të cilat ballafaqohet Policia e Kosovës gjatë kryerjes së detyrave dhe aktivitetit policor dhe pas vlerësimit të gjendjes në teren, IPK-ja ka dhënë rekomandime të nevojshme menaxherëve të strukturës policore, që janë kompetent për marrjen e veprimeve drejtë përmirësimit të performancës policore.

REKOMANDIMET:

1. IPK-ja, Rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës që sa ma parë që është e mundur të udhëzoj azhurnimin e Udhëzimit Administrativ 2/2012 Për Përdorimin e forcës nga ana e zyrtarëve policorë, në mënyrë që të bëhet harmonizimi i plotë mes normave të këtij udhëzimi si dhe formularit për raportimin e përdorimit të forcës.

2. IPK-ja Rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës dhe Drejtorëve të DRP-ve që të angazhohen më shumë rreth ngritjes së realizueshmërisë së vijimit të kursit të certifikimit për personelin policor në kuadër të stacioneve dhe njësive që operojnë në kuadër të këtyre Drejtorive.

3. IPK-ja rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së dhe Divizionit të Trajnimeve që për personelin

e inkuadruar në kuadër të DRP-Mitrovica e Veriut të merren veprimet e nevojshme që personeli i kësaj Drejtorie (zyrtarët policor të integruar në PK) të pajiset me trajnime shtesë me qëllim të arritshmerisë dhe përfitimit të njohurive për kryerjen e detyrave dhe përmirësimit të performancës policore.

4. IPK-ja Rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës që sa ma parë që është e mundur të udhëzoj hartimin e një Procedure Standarde të Operimit që do ta rregullonte qartë hapat dhe veprimet policore në fushën e aplikimit të përdorimit të forcës dhe raportimit të saj.

5. IPK-ja rekomandon menaxherët e stacioneve policore që të inkurajojnë dhe kërkojnë përgjegjësi dhe llogaridhënie nga vartësit e tyre për zbatimin e rregullave ligjore që dalin nga Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 Për përdorimin e forcës nga ana e zyrtarëve policorë, në mënyrë që çdo rast i përdorimit të forcës nga policia sipas rregullave dhe procedurave të shkruara të raportohet sipas zinxhirit komandues.

6. IPK-ja rekomandon Shefat e Divizioneve të Administratës nëpër Drejtori Regjionale të PK-së që të aplikojnë arkivimin e dosjeve të rasteve të përdorimit të forcës në kuadër të këtyre sektorëve pavarësisht ruajtjes së tyre në stacione apo njësi nga të cilat është iniciuar rasti.

7. IPK-ja rekomandon Drejtoritë Regjionale të PK-së që të aplikojnë programe trajnuese në fushën e përdorimit të forcës, në kuadër të trajnimeve të brendshme me qëllim të plotësimit dhe rifreskimit më të shpeshtë të njohurive të zyrtarëve policorë me rregullat dhe procedurat policore për përdorimin e forcës nga policia.

INSPEKTOHET MENA EMERGJENTE NË PC



IPK ka vlerësuar në përgjithësi pozitivisht mënyrën se si policia trajton thirrjet nga qytetarët bazuar në objektivat që kanë qenë fokus i inspektimit, mirëpo, IPK-ja gjatë inspektimit ka konstatuar se niveli i përgjithshëm i performancës së qendrave komunikuese mund të ngritet në nivel më të lartë

Menaxhimi i Thirrjeve të Natyrës Emergjente në Policinë e Kosovës



Menaxhimi i thirrjeve të natyrës emergjente që pranohen në Policinë e Kosovës, shihet si një fushë e rëndësishme si për jetën e qytetarëve që thërrasin në këtë linjë pa pagesë (092 ose 192) ashtu edhe për zyrtarët policorë që reagojnë varësisht nga natyra e thirrjes.

Bazuar në këtë si dhe në planin vjetor të inspektimeve të rregullta të vitit 2014, Inspektorati Policor i Kosovës - Departamenti i Inspektimeve

me autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv, ka bërë një inspektim të rregullt në Policinë e Kosovës në fushën “Inspektimi i Menaxhimit të Thirrjeve në Policinë e Kosovës”.

Në kuadër të këtij inspektimi janë përfshirë: Qendrat Operative Komunikuese Koordinuese, Qendrat Operative Komunikuese Rajonale, dhe Zyrat e Dispeçerëve të Stacioneve Policore.

Qëllimi i këtij inspektimi ka qenë

identifikimi i një menaxhimi të mirëfillt të thirrjeve në Policinë e Kosovës, përmes së cilit do të lehtësohej marrja, ruajtja, analizimi si dhe shfrytëzimi i këtyre të dhënave, në drejtim të shërbimit të qytetarëve dhe krijimit të një ambienti të sigurt publik.

Poashtu rëndësisë së veçantë ka qenë të siguroarit se procedurat standarde të operimit të Qendrës Operative Komunikuese Koordinuese



Koordinuese duke përfshirë edhe qendrat rajonale garantojnë një unifikim dhe përbushje të nevojave për kryerje të efektshme të punës së dispeçerit.

Inspektimit në këtë fushë i ka paraparirë faza hulumtuese dhe hartimi i programit inspektues përfshirë edhe përzgjedhjen e metodologjisë së punës.

Inspektimet janë zhvilluar në teren prej datës 28 mars deri më datën 24 prill 2014, dhe periudha e vlerësuar ka përfshirë periudhën kohore nga data 01.01.2013 deri më 31.12.2013, me ç'rast janë verifikuar të dhënat si dhe gjendja aktuale e qendrave operative komunikuese në nivel drejtorie dhe stacioneve policore.

IPK ka vlerësuar në përgjithësi pozitivisht mënyrën se si policia trajton thirrjet nga qytetarët bazuar në objektivat që kanë qenë fokus i inspektimit, mirëpo, IPK-ja gjatë inspektimit ka konstatuar se niveli i përgjithshëm i performancës së qendrave komunikuese nuk është i kënaqshëm.

Kjo është vlerësuar duke bërë krahasime në aspekte të ndryshme si përcaktimi i kohës së reagimit, standardizimi i PSO-ve, unifikimi i

raporteve, unifikimi i logut ditor dhe plotësimi i tij, pajisjet e vjetruara dhe çështje tjera të cilat janë të paraqitura në këtë raport.

Bazuar në të gjeturat IPK-ja në raportin e saj ka paraqitur edhe rekomandime konkrete drejtuar Policisë së Kosovës, e në të cilin raport janë theksuar nevojat e përmirësimit të performancës së këtyre qendrave komunikuese si një fushë tejet e rëndësishme si për sigurinë e qytetarëve ashtu edhe të zyrtarëve policorë që reagojnë.

Rekomandimet

1. Inspektorati Policor rekomandon menaxhmentin e lartë policor që të angazhohet në nxjerrjen e një dokumenti përmes të cilit do të rregullohej puna e dispeçerisë.

2. Inspektorati Policor i Kosovës i rekomandon menaxherëve të QOKK-së që të intensifikojnë bashkëpunimin me menaxherët e QOKR-ve në mënyrë që Procedurat Standarde të Operimit që rregullojnë këto qendra të jenë të standardizuara dhe unifikuara.

3. IPK rekomandon menaxhmentin e lartë policor të angazhohet që në një kohë të arsyeshme të krijojë një sistem teknologjik dhe funksional në ndarje të burimeve në thirrje emergjente dhe jo emergjente, të cilat më pastaj do të përcaktonin në mënyrë të qartë rrethanat (rastet) e këtyre thirrjeve policore.

4. IPK rekomandon menaxhmentin policor që të shqyrtoj mundësinë e futjes në funksion të Sistemit të Orientimit Global (GPS), në drejtim të rritjes së performancës policore.

5. IPK rekomandon menaxhmentin e lartë policor të angazhohet që në një kohë të arsyeshme të mundësohet incizimi i thirrjeve policore edhe në gjashtë Qendrat Operative Komunikuese Koordinuese Rajonale në mënyrë të njëjtë siç është e rregulluar në Qendrën Operative Komunikuese Koordinuese Rajonale Prishtinë.

6. IPK rekomandon që përgjegjësit për ndërlidhje me institucionet apo departamentet në kuadër të policisë me MPB-në të intensifikojnë bashkëpunimin me këto institucione si dhe të jenë më azhur në rifreskimin e të dhënave në data bazat për verifikimin e personave dhe automjeteve me qëllim të evitimit të vështirësive që iu paraqiten operatorëve gjatë verifikimit.

7. IPK i rekomandon drejtorëve regional dhe komandantëve e stacioneve policore që të angazhohen në mënyrë që në ato objekte ku ka mundësi apo hapësira të bëhet akomodim më i mirëfilltë i Qendrave Operative Komunikuese Koordinuese Rajonale.

8. IPK i rekomandon drejtorëve rajonal dhe komandantëve të stacioneve që të angazhohen në atë mënyrë që aty ku ka nevoja imediate, zyrtarët që punojnë në Qendrat Operative Komunikuese Koordinuese Rajonale të pajisen me mjete të reja pune, konkretisht me kompjuter, karrige dhe broshura që dalin si nevojë e detyrave që lidhen me dispeçerin.

9. IPK rekomandon që të krijohet një trajnim unik dhe i standardizuar për të gjithë operatorët e QK-ve (policë dhe staf civil), me qëllim që ky trajnim të jetë bazë për njohuritë e domosdoshme të një operatori komunikues.



Shkolla e Stafit Policor dhe Komandës

Në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), trajnimi dhjetë javor “Shkolla e Stafit Policor dhe Komandës” ka hyrë në fazat e fundit të tij. Në këtë trajnim po marrin pjesë 42 udhëheqës të lartë të policisë nga të gjitha vendet e rajonit.

Këtë trajnim përveç përfaqësuesve të Inspektoratit Policor të Kosovës dhe Policisë së Kosovës, janë duke e ndjekur edhe përfaqësues të lartë nga policia e Shqipërisë, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia dhe Mali i Zi.

Ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, tha se trajnimi i përbashkët i oficerëve policorë nga vendet e rajonit do të mundësojë thellimin e bashkëpunimit me qëllim të sigurimit të një ambienti të qetë dhe të sigurt.

“Ky model i trajnimeve duhet të jetë edhe model i bashkëpunimit mes vendeve të rajonit”, tha Rexhepi.

**Kosova dhe rajoni
përkrahjet edhe
me një trajnim
të organizuar
nga ICITAP-i me
ligjërues ekspert
nga Universiteti
Northwestern**

Ai falënderoi ICITAP-in dhe Qeverinë Amerikane për përkrahjen e vazhdueshme që po i japin Kosovës në gjitha fushat.

Ndërsa drejtori i Përgjithshëm i Akademisë Ismail Smakiqi, tha se mbajtja e këtij trajnimi e bënë Akademinë edhe më të besueshme për vendet e regjionit dhe partnerët e saj, hap perspektivë të partneritetit me të gjitha institucionet akademike të ngjashme në regjion dhe më gjerë.

“Dimensioni regjional i Shkollës Ndërkombëtare e bën të pakrahasueshëm këtë kurs dhjetë javor, aq më parë kur mbahet nga Universiteti Northwestern, lider i Universiteteve të Sigurisë Publike në botë”, u shpreh Smakiqi.

Ky trajnim është organizuar nga ICITAP-i, ndërsa ligjërues janë ekspert nga Universiteti Northwestern



VAZHDON FUQIZIMI I BASHKËPUNIMIT NË MES TË IPK-SË DHE PK-SË



Në kuadër të fuqizimit të bashkëpunimit në mes IPK-së dhe PK-së si dhe trajtimit të çështjeve profesionale në kuadër të zbatimit të ligjit për IPK-në dhe PK-në u organizua takimi i radhës në mes pozitive udhëheqëse të këtyre dy institucioneve. Si tema të diskutimit në këtë takim bazuar në agjendën e përgatitur më

herët ishte bashkëpunimi IPK-PK gjatë veprimtarisë hetimore bazuar në ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës (neni 17), informatat kthyes nga Drejtoria e Standardeve Profesionale për IPK-në, njoftimet lidhur me ndryshimet e akteve nënligjore të IPK-së dhe PK-së, bashkëpunimi IPK-PK me rastin

e inspektimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme nga departamenti i Inspektimeve, rekomandimet dhe informatat kthyes nga Policia e Kosovës etj.

Gjatë takimit nga të pranishmit u diskutua për secilën temë të paraparë në bazë të agjendës duke dhënë edhe

Në ndërtesën e Inspektoratit Policor u organizua takimi i radhës në mes pozitive udhëheqëse të këtyre dy institucioneve



rekomandime se si mund të fuqizohet akoma më shumë bashkëpunimi.

Ndër propozimet e rëndësishme që dolën si rezultat i këtij takimi ishin:

- PK-ja të gjejë mënyra për informimin e zyrtarëve të saj lidhur me obligimet ligjore që kanë për raportim me kohë të IPK-ja në rastet kur zyrtari policor është i dyshuar për ndonjë vepër penale.

- IPK-ja dhe PK-ja të shqyrtojnë ofrimin e qasjes për IPK-në në bazat e të dhënave të PK-së (të formohet një grup punues, të përcillet kërkesa nga IPK-ja në PK).

- IPK-së t'i përcillen informatat kthyesë (vendimet nga Komisioni Disiplinor dhe Komisioni i Ankesave), për rastet të cilat janë referuar nga IPK-ja.

- IPK-ja dhe PK-ja në mënyrë reciproke të njoftojnë njëra tjetrën për ndryshimet e akteve ligjore dhe nënligjore (të shqyrtohet mundësia e qasjes nga IPK-ja në intranetin e PK-së).

- Identifikimi i përbashkët i fushave të inspektimit në mënyrë që edhe PK-

ja të paraqesë ndonjë kërkesë lidhur me nevojat e saja për inspektim të ndonjë fushe të caktuar.

- Rekomandimet që dalin nga Inspektimet e IPK-së, të vendosen në planifikimet vjetore dhe në raportin vjetor të PK-së.

Në kuadër të bashkëpunimit, takimi i radhës në mes të IPK-së dhe PK-së pritet të mbahet në javët e para të muajit dhjetor 2014.





PAMJE NGA TAKIMI IPK-SHÇBA

Inspektorati Policor Kosovës priti një delegacion të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA)

Tash e disa vite me radhë IPK-ja ka intensifikuar bashkëpunimin me Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat të Republikës së Shqipërisë. Ky intensifikim i bashkëpunimit po përcillet me vizitat e ndryshme reciproke, pjesëmarrje të përbashkët në konferenca të karakterit ndërkombëtar si dhe shkëmbim të përvojave të mira në fushën e shërbimeve të kontrollit të brendshëm.

Një vizitë e tillë e zyrtarëve të SHÇBA-së në IPK ishte organizuar edhe në fund të muajit tetor 2014. Drejtori i Drejtorisë së Inspektimit nga SHÇBA-ja, z. Florian Sulejmani së bashku me tre kolegë të tij dhe përfaqësues të ICITAP-it amerikan u takuan me homologët nga IPK-ja për të mësuar më shumë mbi procesin e marrjes dhe regjistrimit të ankesave, si dhe mbi përdorimin e bazës së të dhënave për ankesat në IPK.

Gjatë takimit të përbashkët u diskutuan edhe çështje të tjera që ndërlidhen me fushën e inspektimeve, trajtimit të ankesave dhe fushës së marrëdhënieve me publikun.

IPK dhe SHÇBA në të ardhmen e afërt pritet që këtë bashkëpunim edhe ta formalizojnë duke nënshkruar një memorandum bashkëpunimi që ka për qëllim përmirësimin e bashkëpunimit në fushën e shërbimeve të kontrollit të brendshëm në të dy vendet, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit së luftës kundër korrupsionit në radhët e policisë si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të individit.



Shkëmbim përvojash IPK-SHÇBA





RIMS në IPK

Muaj më herët në Ministrinë e Punëve të Brendshme kishin filluar përgatitjet për RIMS - Sistemit për Menaxhimin e Burimeve të Informacionit, projekt i bashkë-financuar nga Byroja e Çështjeve Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe të Zbatimit të Ligjit (INL-US) dhe MPB-ja. Ky projekt është implementuar nga Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnime në Hetime Penale (ICITAP).

Edhe IPK-ja krahas agjencive tjera në MPB kishte filluar përgatitjet për këtë projekt duke plotësuar të dhënat e punonjësve të saj në këtë

Sistemi për Menaxhimin e
Burimeve të Informacionit (RIMS)-
ndihmesë në përmbushjen e
qëllimeve strategjike për rritjen
e efikasitetit, llogaridhënies dhe
transparentës

sistem. Mbi 90% të zyrtarëve të IPK-së arritën që të plotësojnë të dhënat e tyre në rubrikat e kërkuara duke plotësuar informatat e tyre personale dhe profesionale, të cilat në një fazë të më vonshme do të verifikohen nga zyrtarët e burimeve njerëzore nëse përputhen me dosjen fizike.

Zyrtarët e Teknologjisë Informative të angazhuar në kuadër të zbatimit të projektit të RIMS-it kanë qenë disa herë në IPK duke dhënë shpjegimet e tyre rreth rëndësisë së këtij programi.

Në ditën kur RIMS-i u funksionalizua, zyrtarë të MPB-së falënderuan Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë dhe ICITAP-in për kontributin e dhënë në realizimin e këtij projekti.



“Efikasiteti në punë, arritja me kohë e rezultateve të parapara dhe planeve e

programeve të ndryshme, si dhe rritja e transparencës, janë çështje kryesore për një administratë të shëndoshë dhe në harmoni me përpjekjet e Qeverisë së Republikës së Kosovës”, theksoi ministri Rexhepi.

Sistemi për Menaxhimin e Burimeve të Informacionit (RIMS), ndihmon në përmbushjen e qëllimeve strategjike për rritjen e efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ky sistem digjitalizon proceset e brendshme dhe e bën të mundur, e-qeverisjen në MPB dhe agjencitë e saj.

Kompania zhvilluese e sistemit RIMS është CREA-KO, Prishtinë. Ndërkaq, kosto e këtij projekti është rreth 500 mijë dollarë.

Nga Skender Hoti





INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

“Linja e kaltër” në shërbim të qytetarëve

NËSE PRETENDONI SE U JANË SHKELUR TË DREJTAT TUAJA NGA ZYRTARËT POLICORË, RAPORTONI NË LINJËN E KALTËR:

Raportoni pa pagesë



080003333

Së bashku për një polici profesionale

IPK SIGURON KONFIDENCIALITET TË PLOTË NË TRAJTIMIN E INFORMACIONEVE